

## Thirrje për propozime për grante të vogla

### *"GrassRoots Action Support" - GRAS*

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: 12 Nëntor 2018

Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), Lens dhe Friedrich Ebert Stiftung (FES) janë duke implementuar projektin "GrassRoots Action Support - GRAS", financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë.

Qëllimi kryesor i projektit "GrassRoots Action Support-GRAS" është të mbështesë konsolidimin e një kulture tolerante dhe demokratike në Kosovë duke forcuar menaxhimin e brendshëm, llogaridhënien dhe transparencën e shoqërisë civile në nivel lokal. Projekti ka dy objektiva specifike: 1) të përmirësojë të kuptuarit e OSHC-ve për proceset e politikave dhe të institucioneve e akterëve të tjerë relevantë për t'u mundësuar atyre që në mënyrë efektive të angazhohen dhe të bashkëpunojnë me institucionet qeveritare, veçanërisht në nivel lokal; dhe 2) të zhvillojë kapacitetet e OSHC-ve me qëllim që të rritet në mënyrë efikase pjesëmarrja e tyre në procesin e hartimit të politikave.

Thirrja për Propozime në kuadër të këtij projekti synon të mbështesë OSHC-të lokale, në veçanti organizatat me bazë në komunitet, për të kryer aktivitetet e tyre në ndikimin e vendimmarrjes publike përmes kontributeve të tyre profesionale / teknike dhe monitorimin e funksionimit të institucioneve publike.

#### **Fushat kryesore tematike të ndërhyrjes janë:**

1. Qeverisja e mirë: pjesëmarrja qytetare dhe llogaridhënia lokale
2. Drejtësia Sociale: të drejtat socio-ekonomike
3. Promovimi i kulturës dhe trashëgimisë kulturore në nivel lokal

#### **Dispozitat financiare:**

Kjo thirrje për propozime do të ofrojë një minimum prej 20 grantesh për projektet me bazë në komunitet.

Shuma minimale për mbështetje financiare është **3,000 euro** dhe shuma maksimale është **6,000 euro**.

Financimi do të mbulojë 100% të buxhetit të përgjithshëm të projektit. Sidoqoftë, përparësi do t'u jepet aplikacioneve me bashkëfinancim të siguar prej së paku 5% të kostos totale të projektit.

#### **Kohëzgjatja:**

Aktivitetet e zbatuara në kuadër të granteve nuk duhet të zgjasin më shumë se 6 muaj nga data e fillimit të projektit dhe duhet të përfundojnë jo më vonë se më 31 maj 2018. Vetëm në raste të jashtëzakonshme projektet me afat më të gjatë se 6 muaj (por jo më shumë se 12 muaj) do të financohen, dhe atë vetëm pasi të kenë ofruar një arsyetim të fortë për një periudhë të tillë implementimi.

- OShC lokale të regjistruara në Kosovë
- Organizatat jo-fitimprurëse, shoqatat apo fondacionet
- OSHC-të të cilat janë në gjendje të ofrojnë dokumentet e regjistrimit të organizatës (certifikatën e regjistrimit, certifikatën e numrit fiskal) dhe provën që kanë plotësuar të gjitha detyrimet ndaj shtetit, përfshirë Administratën Tatimore dhe informacione të llogarisë bankare)

**Sesionet informative:**

- Prishtinë - 22 tetor 2018, ora 10:00 – 13:00, Qendra Informative dhe Kulture EUICC/EU, Rr. “Nëna Tereza” nr.36
- Gjakovë - 23 tetor 2018, ora 10:00 - 13:00, Qendra Rinore/Zyret e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal
- Mitrovicë – 24 tetor 2018, ora 10:00 – 13:00, Zyret e Agjencisë së Zhvillimit Rajonal në Veri (ARDA)
- Ferizaj – 25 tetor 2018, ora 10:00 – 13:00, Orchide Restaurant, Rr. Ahmet Kaqiku, nr. 35
- Pejë –26 tetor 2018, ora 10:00 – 13:00, Qendra Rinore Zoom
- Prizren –29 tetor 2018, ora 10:00 – 13:00, Kino Lumbardhi, Rr. Remzi Ademi, nr. 4
- Gjilan –30 tetor 2018, ora 10:00 – 13:00, Qendra Rinore Gjilan

**Procesi i aplikimit:**

Dorëzimi i aplikacioneve mund të bëhet në dy forma:

- Shkarkimi i formularëve nga ueb faqja e projektit [www.grasks.com](http://www.grasks.com), plotësimi dhe dorëzimi me e-mail në [gras@iksweb.org](mailto:gras@iksweb.org) , ose
- Aplikimi përmes e-tool, një formulari të aplikimit online i cili mund të qaset nga vegëza <http://grasks.com/apliko-online/> dhe i cili udhëzon aplikuesit gjatë gjithë procesit të plotësimit të aplikacionit në një format të mësimit hap pas hapi.

**Të gjitha aplikacionet duhet të përgatiten dhe të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.**

Pyetjet në lidhje me këtë thirrje për propozime mund të shkruhen dhe të dorëzohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze, në [gras@iksweb.org](mailto:gras@iksweb.org)